



Institute  
for Democracy  
and Mediation

Raport studimor

# Përvoja dhe mundësitë për funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)



EKIPI HULUMTUES:

Dr. Armela Xhaho, autore kryesore dhe hulumtuese shkencore  
Dr. Erinda Bllaca, kontribuese dhe eksperte për çështje e sigurisë

Këshilltar i lartë i studimit : Sotiraq Hroni

Tiranë, 2024



*Shënim*

*Ky studim është hartuar në kuadër të Programit "Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria", zbatuar në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve si dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe me financim të Fondit Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit (GCERF).*

*Pikëpamjet dhe qëndrimet që shprehen në këtë dokument i përkasin vetëm autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e donatorit.*

## SHKURTESA

EDH	Ekstremizmi i dhunshëm
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinor
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
KVSP	Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
LHT	Luftëtarë të huaj terroristë
LKEDH	Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
NJVQV	Njësi e vetëqeverisjes vendore
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PCVE	Parandalimi dhe kundërvënia ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm
PMF	Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës
R&R	Rehabilitimi dhe riintegrimi
SNSK	Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet
PIM	Plani Individual i Mbrojtjes
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>SHKURTESA</b> .....	<b>3</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
Konteksti “formal” i funksionimit aktual të KVSP-ve .....	6
Praktika të mira: Funksionimi i KVSP-së në Bashkinë Elbasan .....	7
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>9</b>
<b>SEKSIONI I. PËRSHKRIMI I KAMPIONIT</b> .....	<b>10</b>
<b>SEKSION II: ANALIZA E GJETJEVE</b> .....	<b>13</b>
Pjesëmarrja dhe anëtarësia në KVSP .....	14
Kudri rregullator i KVSP-së .....	15
Efektiviteti dhe efikasitetit i KVSP .....	16
Kordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional.....	18
Kapacitetet e anëtarëve të KVSP.....	20
Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rolin dhe funksionimin e KVSP-SË .....	22
Raportimi dhe monitorimi.....	23
<b>SEKSIONI III. QASJA SHUMAKTORIALE DHE PARTNERITETET E QËNDRUESHME</b> .....	<b>25</b>
Qasja shumaktoriale.....	26
Qasja e orientuar sipas nevojave të kontekstit vendor .....	28
<b>PËRFUNDIME</b> .....	<b>31</b>
<b>REKOMANDIME</b> .....	<b>31</b>
<b>SHTOJCA</b> .....	<b>37</b>

## HYRJE

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) është një mekanizëm këshillimor, i cili ngrihet dhe funksionon në çdo bashki me qëllim hartimin e politikave dhe plan-veprimeve gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në rritjen e sigurisë publike në nivel vendor.<sup>1</sup> Praktika e deritanishme ka treguar se zbatimi efektiv i këtij mekanizmi nga institucionet vendore ka qenë një sfidë e vazhdueshme. Të ngritura në 58 bashki të vendit, këto mekanizma kanë ofruar qasje të ndryshme në lidhje me adresimin e çështjeve të sigurisë vendore, por që janë ende larg një modeli të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës. Karakteri formal i funksionimit të tyre evidentohet dhe në dokumentin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet (SNSK) 2021 – 2026<sup>2</sup>. Strategjia nxjerr në pah mungesën e zbatimit efektiv dhe praktik të këtij mekanizmi, i cili nuk ka dhënë efektet e pritshme në lidhje me trajtimin e duhur të çështjeve të sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion.

KVSP është konceptuar si një mekanizëm gjithëpërfshirës dhe shumaktorial në nivel vendor i cili mbështetet në partneritetin horizontal të institucioneve publike dhe jopublike. Mirëfunksionimi i këtij mekanizmi pranë bashkive jo vetëm që ndihmon në adresimin e kërcënimeve konvencionale që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe me sigurinë publike, por edhe më tej në parandalimin e fenomeneve të tjera, të tilla si radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Po ashtu, ky mekanizëm kontribuon në parandalimin dhe luftën kundër krimit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve. Për më tepër, kjo qasje i jep bashkisë rolin e munguar në qeverisjen e sigurisë dhe në përmirësimin e shërbimeve në fushën e sigurisë dhe rendit publik, funksion të cilën bashkia duhet ta ushtrojë në zbatim të ligjit organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në kuadër të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) zhvilloi një hulumtim për të vlerësuar përvojën dhe mundësitë për funksionimin e KVSP-ve. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë perceptimet dhe përvojën e profesionistëve të vijës së parë dhe aktorëve në nivel vendor në lidhje me funksionimin dhe efikasitetin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike si një mekanizëm për trajtimin e problemeve të sigurisë publike në nivel vendor. Nga ana tjetër, studimi ofron të dhëna dhe rekomandime të bazuara në evidencë, të cilat mund të përdoren nga politikëbërës të nivelit vendor dhe qendror për hartimin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse për funksionimin e KVSP-së.

---

<sup>1</sup> Udhërrëfytyesi “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)”, Janar 2023. <https://idmalbania.org/sq/udh%D1%91rr%D1%91fyes-per-ngritjen-dhe-funksionimin-e-keshillave-vendore-te-sigurise-publike-kvsp/>

<sup>2</sup> Vendim Nr. 1139, datë 24.12.2020, ‘Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe Planit të Veprimit 2021-2023. <https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2021/01/STRATEGJIA-ND%C3%8BRSEK>

## Konteksti “formal” i funksionimit aktual të KVSP-ve

Referuar Strategjisë Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet, koncepti i *sigurisë publike në komunitet* është ridimensionuar si përgjigje ndaj zhvillimeve social-ekonomike, politike dhe ndërkombëtare të vendit. Ky koncept është zgjeruar edhe në rrafshin horizontal duke përfshirë [krahas policisë] çdo përfaqësues të pushtetit vendor, institucione si Policia e Shtetit dhe prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm, qytetarët dhe komunitetet, institucionet e tjera joqeveritare, forumet qytetare, institucionet fetare, bizneset dhe mediat, si dhe aktorë të tjerë të pushtetit qendror. Sfidat që lidhen me ruajtjen e sigurisë publike dhe parandalimin e kriminalitetit në tërësi nuk mund të përballen vetëm me qasje konfrontuese ose nga një institucion i vetëm, por paralelisht duhet të punohet me ndërgjegjësimin e publikut, duke përfshirë këtu një qasje shumaktoriale që garanton angazhimin e institucioneve qendrore e vendore, të shoqërisë civile, biznesit dhe medias, etj. Garantimi i sigurisë publike për komunitetin, krahas kuadrit rregullator, kërkon angazhim strukturor dhe institucional për mirëfunksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike si një mekanizëm i përhershëm pranë njësive të vetëqeverisjes vendore që kujdeset për sigurinë e qytetarëve dhe garantimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies sociale të tyre.

Për arritjen e qëllimeve strategjike dhe garantimin e sigurisë publike për komunitetin si dhe në analizën krahasimore të praktikave të deritanishme evidentohet nevoja për të pasur mekanizma që kanë role dhe përgjegjësi të qarta, transparencë dhe llogaridhënie gjatë funksionimit të tyre.

Në pozicionin e udhëheqësit dhe drejtuesit të KVSP, pushteti vendor orienton, fton dhe angazhon në takime ndër-institucionale aktorët e lartpërmendur dhe, në veçanti, qytetarët. Intensifikimi i bashkëpunimit me qytetarët dhe angazhimi i tyre është ‘gur themeli’ jo vetëm në identifikimin dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale por edhe në rritjen e sigurisë publike të komuniteteve vendore. Në këtë mënyrë, arrihet garantimi i parimeve të demokracisë vendore, i pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirjes për çdo aktor.

Dokumente të ndryshme strategjike për parandalimin dhe luftën kundër krimit si dhe për sigurinë në komunitet theksojnë rëndësinë e angazhimin dhe përfshirjes së qytetarëve në takimet e KVSP-së. Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 parashikon organizimin e takimeve të Këshillave Vendorë për Sigurinë Publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për krimin e organizuar<sup>3</sup>. Po ashtu, në kuadër të konsolidimit të strukturave të KVSP-së, Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 parashikon rritjen e pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në KVSP, nëpërmjet ndërmarrjes së fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit nga KVSP-të lidhur me rreziqet e sigurisë në komunitet dhe informimin e publikut për rolin e të gjithë aktorëve institucionalë në nivel vendor.

---

<sup>3</sup> Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025. <https://mb.gov.al/wep-content/uploads/2021/01/STRATEGJIA-KUND%C3%8BR-KRIMIT-T%C3%8B-ORGANIZUAR-DHE-KRIMEVE-T%C3%8B-R%C3%8B-NDA-2021-2025-DHE-PLANI-I-VEPRIMIT-2021-2022.docx>

Një qasje e tillë kërkon standarde të larta profesionale nga administrata vendore dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak për identifikimin e hartës së kërcënimeve ndaj sigurisë publike, në përputhje me veçoritë/dinamikat dhe njohjen e problematikave që shqetësojnë komunitetet vendore. Ekzistenca e këtyre standardeve profesionale, në fakt, përbën një nga vështirësitë kryesore të strukturimit të më pas të funksionimit të KVSP-ve. Deri më sot, ky proces është bërë “formalisht” dhe nuk ka qenë efikas, ndaj theksi vihet tek këto standarde dhe tek përgatitja e rregullores së funksionimit të mekanizmit si dhe bashkëpunimi, shkëmbimi i informacionit dhe gjithëpërfshirja që në fazat e para të strukturimit të tij. Profili dhe njohuritë profesionale të anëtarëve të KVSP-së, gjithëpërfshirja dhe standardizimi i instrumenteve për identifikimin e prioriteteve të sigurisë publike në nivel vendor lehtëson procesin ndërinstucional për hartimin e planeve operacionale shumaktoriale dhe strategjive vendore të sigurisë publike.

Procesi i identifikimit të risqeve të sigurisë, analizës dhe ndikimit të tyre në komunitet nuk është shoqëruar me ndonjë metodologji të konsoliduar si dhe formulim të qartë të qëllimeve, objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve të pritshme. Rolet dhe përgjegjësitë e çdo aktori në mekanizëm duhet të jenë të qarta. Çdo drejtues institucioni, ndjek aktivitetet e institucionit që ai drejton për t’u siguruar që këto aktivitete kryhen sipas udhëzimeve të dhëna.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia funksionojnë në të gjitha nivelet duke siguruar zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, shoqëruar kjo me një plan konkret veprimi, në të cilin pasqyrohen problematikat reale të komuniteteve vendore. Sa më konkret plani, aq më koherent bëhet zbatimi i tij nga bashkitë përkatëse. Hartimi i një plani të tillë veprimi, shoqëruar me aktivitete të realizueshme, duhet të integrojë edhe një metodologji monitorimi të dakordësuar nga palët, për të paraqitur ecurinë e realizimit të aktiviteteve të planifikuara.

Qasja e bashkisë ndaj sigurisë publike do të thotë që qëllimi i saj madhor është të kthejë territorin e kësaj bashkie në një vend të sigurt për qytetarët e saj. Për të realizuar këtë qëllim, kërkohet informim dhe ndërëgjegjësim i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me aktivitetet e planifikuara, duke fuqizuar rolin e tyre ndërveprues në këtë proces të rëndësishëm. Transparenca në lidhje me situatën reale të sigurisë publike, llogaridhënia e shoqëruar me procese të hapura të konsultimit publik, përfshirja dhe ndarja e përgjegjësisë që lidhen me sigurinë publike bëjnë që KVSP-të nga struktura formale të kthehen në struktura dinamike.

### **Praktika të mira: Funksionimi i KVSP-së në Bashkinë Elbasan**

Modeli i ngritjes dhe funksionimit të KVSP-së në Bashkinë Elbasan, i njohur ndryshe si modeli i “trekëndëshit” institucional të ndërveprimit bashki-polici-prokurori, orienton planet e veprimit dhe masat konkrete për parandalimin e krimit dhe sigurisë publike përmes një qasje gjithëpërfshirëse. Nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, Shefit të Komisarariatit dhe Prokurorit pranë Gjykatës të Juridiksionit të Përgjithshëm në këto konsultime publike u përfshinë edhe përfaqësues të komuniteteve vendore si kryetarë fshatrash, ndërlidhës komunitarë, përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, biznesit, shoqërisë civile, komuniteteve fetare, medias e qytetarëve të ndryshëm të interesuar, shkollat dhe të rinjtë.

Gjatë periudhës 2018-2019, IDM në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë, drejtuesit vendorë të policisë dhe Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan zhvilluan një sërë takimesh të hapura konsultative për hartimin e një programi vendor të sigurisë përmes komunikimit me qytetarët dhe llogaridhënien publike. Këto takime konsultative të hapura të “trekëndëshit” u lidhën organikisht me veprimtarinë e KVSP-së duke krijuar premisa për t’i dhënë një karakter konkret dhe të prekshëm bashkëpunimit ndërinstytucional në luftën kundër kimit. Përfaqësuesit e institucioneve të “trekëndëshit” i analizuan dhe shndërruan kërcënimet dhe problematikat e ndryshme të evidentuara nga qytetarët në takimet e hapura në objektiva pune të një plani shumaktorial vendor (Korniza e Strategjisë së Sigurisë në Komunitet dhe Strategjia e Komunikimit). Kjo praktikë e shndërron Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në “një qendër gjithëpërfshirëse të vlerësimit të prioriteteve dhe të hartimit të politikave për sigurinë vendore”. Mbështetur në këtë përvojë disavjeçare, KVSP e Elbasanit rikonceptoi rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike”, e cila u miratua nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 2, datë 04.03.2022<sup>4</sup>.

Puna e KVSP në Bashkinë Elbasan është e përqëndruar në tre objektiva kryesore:

1. Fuqizimi i partneriteteve lokale dhe kombëtare me institucionet publike, shoqërinë civile dhe komunitetin.
2. Të kuptuarit e përbashkët për prioritizimin e problematikave të lidhura me sigurinë publike.
3. Fuqizimi i partneriteteve rajonale dhe ndërkombëtare.

Përgjatë vitit 2023, KVSP në Bashkinë Elbasan ka zhvilluar një sërë aktiviteteve me të rinjtë, përfaqësues të institucioneve vendore dhe komunitetin:

- 4 takime të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike ku janë trajtuar problematika të ndryshme si: parandalimi dhe lufta kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore; mbrojtja e fëmijëve; kontrolli i territorit për identifikimin e hotspotëve të kultivimit dhe konsumimit të lëndëve narkotike; rritja e sigurisë në shkolla; rritja e sigurisë rrugore; mbrojtja e mjedisit;
- 1 forum të organizuar me të rinjtë me prezencën edhe të Ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar Alastair King-Smith. Në fokus të këtij forumi ishin çështjet e lidhura me sigurinë si edhe inkurajimi i të rinjve dhe organizatave rinore që të bëhen zëra të fortë brenda komuniteteve të tyre, të kërkojnë më shumë llogaridhënie nga institucionet, të ndërmarrin veprime të përgjegjshme dhe të angazhohen në vendimmarrje;
- 1 shkëmbim qytetesh (me përfaqësues nga Ballkani Perëndimor);
- 1 shkëmbim qytetesh (me Bashkinë Gramsh, Cërrik dhe Lushnjë);
- Pjesëmarrje e KVSP Elbasan në Samitin e Katërt Global të Qyteteve të Forta ku u diskutua ndër të tjera rreth rolit që kanë kryetarët e bashkive dhe liderët e tjerë lokalë në çështjet e parandalimit dhe reagimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

---

<sup>4</sup> Shih: <https://idmalbania.org/sq/bashkia-elbasan-miratton-rregulloren-e-re-dhe-planin-nderinstytucional-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-keshillitvendor-per-sigurine-publike/>



Bashkia e Elbasanit ka në fokus kryesor perspektivat rinore në KVSP, duke përfshirë përfaqësues të disa organizatave me bazë komunitare, të cilat punojnë drejtpërdrejt me të rinjtë. Bashkia ka themeluar gjithashtu një këshill rinor lokal i cili jep kontribut në politikbërjen e përgjithshme dhe informon punën e KVSP. Përfaqësuesit nga policia dhe shërbimet e prokurorisë së Elbasanit i kushtojnë rëndësi sensibilizimit të stafit të tyre për t'u angazhuar me të rinjtë dhe adoptimin e një qasjeje proaktive ndaj parandalimit të fenomeneve negative. Në kuadër të sensibilizimit më të madh të komunitetit dhe rritjes së transparencës, bashkia harton dhe publikon edhe një buletin informues për aktivitetet e KVSP, i cili promovon edhe angazhimin e të rinjve në jetën lokale.

## METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë perceptimet dhe përvojën e profesionistëve të vijës së parë dhe aktorëve në nivel vendor mbi funksionimin dhe efikasitetin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. Studimi synon gjithashtu të informojë institucionet në nivel vendor dhe qendror si dhe aktorët e tjerë të interesit mbi progresin e deritanishëm, nevojat e ardhshme dhe rekomandimet për hartimin dhe promovimin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse për funksionimin e KVSP-së. Për të siguruar saktësinë dhe cilësinë e gjetjeve dhe përfundimeve u përdor një **qasje me metoda të kombinuara**.

### **Metoda sasiore: Sondazhi me profesionistë të vijës së parë dhe aktorë në nivel vendor**

Pyetësori gjysmë i strukturuar u plotësua nga 81 profesionistë të vijës së parë dhe aktorë në nivel vendor, përfshirë anëtarë të KVSP-së. Pyetësori u administruan online në 20 bashki, të cilat u përzgjodhën në varësi të madhësisë, gjeografisë dhe dinamikave të çështjeve të sigurisë. Qëllimi i këtij instrumenti është të mbledhë informacion nga profesionistët e vijës së parë dhe aktorët në nivel vendor lidhur me dijeninë e tyre për KVSP-në, pjesëmarrjen në takimet e KVSP-ve, efikasitetin në koordinimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional. Instrumenti shqyrtoi ndër të tjera perceptimet e aktorëve lidhur me qasjet më efektive për mirëfunksionimin e tij. Procesi i mbledhjes së të dhënave sasiore u realizua online nëpërmjet Google Forms gjatë periudhës dhjetor 2023-janar 2024.

### **Metoda cilësore: Diskutime me grupe të fokusuara**

Diskutimet në fokus grupe u realizuan përgjatë periudhës nëntor-dhjetor 2023 në 7 bashki të vendit: Kukës, Mat, Pogradec, Tiranë, Cërrik, Shkodër dhe Elbasan. Në këto takime morën pjesë 81 përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, përfshirë anëtarë të KVSP-së, niveli i lartë drejtues, specialistë nga stafi drejtues dhe operacional (NJMF/PMF; administratorë socialë nga njësitë administrative, përfaqësues të strukturave të policisë, të shërbimeve sociale, strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, anëtarë të Këshillit Bashkiak si dhe aktorë të tjerë në nivel vendor. Diskutimi u orientua në identifikimin e sfidave dhe përvojave në organizimin e punës, zbatimin e procedurave të brendshme, informimin dhe ndërgjegjësimin për KVSP-të si dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së kapaciteteve profesionale.

### **Takime/Intervista gjysmë të strukturuar me anëtarë të KVSP**

Me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me proceset e funksionimit të KVSP-ve, me proceset vendimmarrëse dhe me organizimin e punës dhe mbështetjen e ofruar u realizuan 4 intervista


gjysmë të strukturuar me anëtarë të KVSP-ve dhe me përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet vendore.

## **SEKSIONI I. PËRSHKRIMI I KAMPIONIT**




Figura 1 më poshtë, paraqet shpërndarjen gjeografike të të anketuarve në 20 bashki dhe tregon që përfaqësimin më të madh e ka bashkia e Tiranës me 23.5%, pasuar nga bashkia e Pogradecit me 13.6% dhe ajo e Elbasanit me 11.1%.

Figura 1. Bashkitë




Përsa i përket shpërndarjes gjinore, rreth 72% e të anketuarve janë femra dhe 29% meshkuj. Shih Figurën 2 më poshtë.

Figura 2. Gjinia




Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve i përkasin grupmoshës 37-67 vjeç (57%), pasur nga të anketuarit e grupmoshës 16-36 vjeç.

Figura 3. Mosha (në vjeç)




Të pyetur në lidhje me sektorin e punësimit, të dhënat e paraqitura në Figurën 4 tregojnë se 37% janë të punësuar në institucionet e qeverisë vendore, të tilla si bashkia ose njësi administrative, pasur nga 27% që janë profesionistë pranë institucioneve arsimore dhe 16% që janë të angazhuar me shoqërinë civile.

Figura 4. Sektori i punësimit



Shumica e të anketuarve, 72.8% janë të angazhuar në sektorët përkatës prej më shumë se 5 vite, pasuar nga profesionistët e rinj në sektor që përbejnë 16% të kampionit dhe kanë më pak se një vit që punojnë në sektor, siç tregohet në Figurën 5.

Figura 5. Prej sa kohësh punoni në këtë sektor?



## SEKSION II: ANALIZA E GJETJEVE




Në pjesën e mëposhtme të këtij raporti analizohen gjetjet kryesore të përfituara nga instrumenti i sondazhit dhe nga diskutimet në fokus grupe. Analiza e gjetjeve kryesore është e ndarë sipas tematikave kryesore të studimit.

### Pjesëmarrja dhe anëtarësia në KVSP

Në këtë rubrikë përshkruhen rezultatet lidhur me njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor mbi KVSP si dhe angazhimin e tyre në veprimtarinë e KVSP-të në bashkitë përkatëse. Gjithashtu, të anketuarit janë pyetur edhe për mundësitë për rritje kapacitetesh në lidhje me tematikat kryesore që adresohen prej KVSP-së. Rezultatet e pasqyruara në Figurën 6 tregojnë që shumica e të anketuarve janë dijeni për KVSP-të ndërsa 24.7% kanë thënë të kundërtën.

Figura 6. A jeni në dijeni të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në bashkinë tuaj?



Të pyetur në vijim nëse kanë marrë pjesë në takimet e KVSP-së në cilësinë e anëtarit, vetëm 28.4% e profesionistëve kanë pohuar që kanë marrë pjesë, ndërsa shumica (65.4%) nuk kanë marrë pjesë në asnjë takim të KVSP-së (shih Figurën 7).

Figura 7. A keni marrë pjesë në cilësinë e anëtarit në takimet e KVSP?





Figura 9 më poshtë paraqet shpeshtësinë e pjesëmarrjes në mbledhjet e KVSP-së në dy vitet e fundit vetëm për profesionistët të cilët kanë marrë pjesë në takime të organizuara nga KVSP-të në cilësinë e anëtarit. Të dhënat tregojnë që gjysma e të pyeturve kanë marrë pjesë 1 deri në 2 herë

në takime, pasuar nga 31.8% që kanë qenë 3-4 herë të pranishëm dhe 18.2% që kanë marrë pjesë më shumë se 5 herë.

Figura 8. Sa herë keni marrë pjesë në mbledhje e KVSP-së në dy vitet e fundit?



Sipas të dhënave nga fokus grupet, funksionimi i KVSP-së nuk ndjek procedurat e përcaktuara, të tilla si takime periodike të anëtarëve të KVSP. Aktualisht, nga 20 bashki të vlerësuara, vetëm 2 (20%) zhvillojnë rregullisht takime (7-8 takime), ndërsa pjesa tjetër e anëtarëve të KVSP-së kanë raportuar nga 0-2 takime në dy vitet e fundit. Sipas të dhënave nga fokus grupet rezulton se natyra e takime është në pjesën më të madhe të rasteve pa objektiva të qarta dhe pa ndonjë axhendë paraprake. Shpeshtësia e pjesëmarrjes në mbledhjet e KVSP-së është një tregues sasior në lidhje me funksionimin e mekanizmit dhe numri i ulët i mbledhjeve të anëtarëve nxjerr në pah karakterin “formal” të këtyre strukturave.

### Kuadri rregullator i KVSP-së


Edhe pse KVSP janë krijuar formalisht në 58 bashki në vend, nuk ka një kuadër të qartë rregullator për funksionimin e tyre, pavarësisht problematikave me të cilat përballen bashkitë në trajtimin e kërcënimeve të sigurisë në nivel vendor, duke përfshirë çështjet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe të rikthimit dhe riintegritimit të qytetarëve nga zonat e konfliktit. Përvoja e deritanishme në bashki të ndryshme të vendit ka treguar se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet ngritja dhe funksionimi i Këshillave Vendor të Sigurisë Publike është e ndryshme. Këto ndryshime prekin objektivat dhe strukturën organizative, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, nivelin e përfshirjes qytetare, rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces. Të gjithë këto ndryshime së bashku me një proces dinamik konsultimi dhe llogaridhënie me qytetarët ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e punës së Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike.<sup>5</sup>

Në Figurën 10 më poshtë, profesionistët janë pyetur nëse janë në dijeni të ndonjë rregulloreje që orienton/udhëzon funksionimin e KVSP-së në bashkinë e tyre. 81.8% kanë pohuar se janë në dijeni që ka një rregullore të tillë, ndërsa 18.2% pohojnë të kundërtën. **Ndonëse pjesa më e madhe e aktorëve në nivel vendor janë në dijeni të ekzistencës së KVSP-së dhe rregulloreve për**

<sup>5</sup> Udhërrëfytyesi “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)”

funkcionimin e tyre, ndërgjegjësimi për përgjegjësitë dhe detyrat e anëtarëve të KVSP si dhe rolin që duhet të ketë ky mekanizëm në adresimin e sfidave të sigurisë është përgjithësisht i kufizuar.

Figura 9. A jeni ju në dijeni të një rregulloreje për funksionimin e KVSP-së në bashkinë tuaj?



#### Rregullat e brendshme për mënyrat e ndarjes së informacionit dhe komunikimit

Nga të dhënat e fokus grupeve me punonjësit e institucioneve në nivel vendor konstatohet se **punonjësit nuk janë në dijeni nëse në bashki ka rregulla të veçanta në lidhje me procedurat e komunikimit mes anëtarëve të KVSP-së.** Si rrjedhojë, për shkak të mungesës së rregullave të brendshme dhe procedurave standarde të punës, **komunikimi dhe koordinimi me strukturat në nivel vendor nuk është aspak efektiv.** Vendosija e linjave të qarta të raportimit dhe monitorimit periodik rrit nivelin e llogaridhënies. Nevojitet standardizimi i proceseve të punës dhe veprimeve (kush bën çfarë), të cilat do të bënin të mundur një bashkërendim dhe komunikim më të mirë mes institucionet anëtare në KVSP.

#### Mbrojtja e konfidencialitetit

Ndonëse në disa raste, takimet e KVSP-së janë të paplanifikuara në kohë, pjesëmarrësit në fokus grupe theksojnë se një element i rëndësishëm në mbledhje e KVSP-së është ruajtja e konfidencialitetit. **KVSP trajton çështje të sigurisë që mund të jenë tepër të ndjeshme** (të tilla si qytetarët e kthyer nga zonat e konfliktit), që nëse keqpërdoren nga media apo aktorë të tjerë mund të përbëjnë problem për sigurinë e komunitetit. **Profesionistët nga institucionet anëtare në KVSP respektojnë kodin e deontologjisë që sanksionon masa disiplinore për thyerjen e parimit të konfidencialitetit.** Ndonëse çdo institucion mund të ketë një kod etik që përfshin rregulla për ruajtjen e konfidencialitetit, është e nevojshme të hartohen udhëzime për ruajtjen e fshehtësisë dhe konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Efikasitetit i funksionimit të KVSP

Nga diskutimet në fokus grupe vlerësohet se efikasiteti i KVSP-së në nivel vendor është ende shumë larg standardeve të dëshiruara. Të dhënët e përfituara nga fokus grupet dhe pyetësorët



**tregojnë që KVSP-të në pjesën më të madhe të rasteve janë jo-funksionale ose kanë një efikasitet shumë të dobët, i cili nuk rezulton në ndonjë ndryshim të qenësishëm në lidhje me trajtimin e çështjeve të sigurisë në nivel vendor.** Disa KVSP janë krijuar si nevojë e një reagimi të menjëhershëm ndërinstitucional ndaj parandalimit dhe luftimit të fenomeneve negative me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë publike. Ndonëse mbledhjet e anëtarëve të KVSP-së nuk kanë qenë sistematike, në disa raste ka pasur një vullnet politik nga ana e bashkive dhe debate konstruktive mes anëtarëve të KVSP-së për të ndërmarrë praktika për parandalimin dhe luftimin e fenomeneve negative që kanë shqetësuar komunitetin, të tilla si ekstremizmi i dhunshëm, bullizmi apo dhuna. Edhe pse fillimi ka qenë premtues, KVSP-të nuk kanë mundur të jenë funksionale, kjo edhe për shkak të faktorëve të jashtëm, të tilla si masat e ndërmarra për izolim gjatë periudhës së pandemisë.

Një pjesëmarrës nga një fokus grup shprehet në lidhje me ngërçin që krijoi pandemia në mbledhjet e KVSP-së:

*Këshilli i Sigurisë në atë kohë mbledhjet për problematikën se ne na klasifikonin atëherë si bashki me njollë të zezë. Në atë kohë kemi qenë shumë të angazhuar të gjithë aktorët së bashku, por siç thanë dhe parafolësit pandemia la shumë gjëra pas. Ne nga ai takim kemi nxjerr dy konkluzione që bashkia jonë me të vërtetë është e vogël, por në realitet dhe në bilancet që ne bëmë me shefin e komisarariatit shumë faktorë nuk na rezultuan aq sa thuhej se ishte bërë në atë kohë. Ne ndamë dhe detyra dhe në atë kohë kishim një koordinim perfekt ndërmjet komisarariatit, drejtorisë së ndihmës sociale, por kjo gjë u la. Që nga ai takim nuk kemi bërë më. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

Një tjetër pjesëmarrës nga një fokus grup shprehet:

*Ne si qendër kemi marrë pjesë në takimet ndoshta para pandemisë dhe kjo ka qenë një fazë e parë në të cilin është shpërndarë një pyetësor për të kuptuar problematikën e bashkisë që lidhen me çështje të sigurisë dhe më pas një takim tjetër konsultues. U vendos që do të kishte takime të tjera një herë në 2-3 muaj nuk e mbaj mend mirë, por pas pandemisë u lanë pak gjërat në heshtje dhe le të themi që ne ishim në pritje që të rimerrej si çështje, sepse problematikën janë të shumta, sidomos kur bëhet fjalë dhe punon me target grupe vulnerabël. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i OSHC-ve)*

**Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se në përgjithësi mbledhjet e KVSP-së janë kryesisht takime formale mes përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në KVSP, të cilët nuk marrin angazhime konkrete pasi nuk kanë një program apo plan pune në lidhje me rolet dhe detyrimet institucionale. Në disa bashki, çështjet e diskutuara në mbledhjet e KVSP-së shpeshherë nuk lidhen me çështjet apo sfidat e sigurisë së komuniteteve.**

Një pjesëmarrëse nga një fokus grup thekson:

*Mirë nuk jemi se ka 4 vite që funksionon Këshilli Vendor për Sigurinë Publike. Unë rastësisht gjendem në këtë pozicion këtu, sepse mund të mos isha. Jam [pozicion drejtues i nivelit të lartë] dhe nuk mbaj mend ndonjëherë të jenë diskutuar tematika*

*të tilla siç po diskutohen sot këtu. Janë bërë disa mbledhje krejtësisht formale për emergjencat civile, disa statistika për policinë. Gjëra thelbësore që janë me të vërtetë problematike për komunitetin nuk janë diskutuar asnjëherë. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

Nga të dhënat e përfituara nga të anketuarit rezulton se disa nga temat kryesore të diskutuara në mbledhjet e KVSP-ve janë: çështje të sigurisë në shkolla dhe kopshte; ndërtimet pa leje; kultivimi i lëndëve narkotike në zonat malore; përfshirja e institucioneve fetare; lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm/mbështetja dhe integrimi i të kthyerve nga konflikti në Siri; siguria dhe rendi publik/siguria në rrugë/siguria gjatë sezonit turistik; dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore; vatrat e nxehta të përdorimit të drogës; bashkëpunimi i trekëndëshit bashki-prokurori-polici; emergjencat civile/zjarret.

Në përfundim, disa nga arsyet e raportuara për efikasitetin e ulët të këtij mekanizmi janë:

- mungesa e protokolleve dhe procedurave standarde të veprimit
- mungesa e instrumenteve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave si dhe dokumentimin e mbledhjeve
- mungesa e burimeve njerëzore, financiare,
- infrastruktura e dobët dhe shërbime mbështetëse të limituara.

Roli i KVSP konsiderohet një “formalitet” dhe kryesisht i kufizuar në emërimin e anëtarëve të KVSP-së. Nevojitet të sigurohet një rol më aktiv i gjithë institucioneve anëtare në KVSP për të shtyrë KVSP-të të bëhen më aktive dhe më bashkëpunuese në nivel vendor. Duhet bërë më shumë përpjekje për të përmirësuar komunikimin ndër-institucional dhe bashkëpunimin nëpërmjet krijimit të një partneriteti horizontal shumaktorial.

### **Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional**

Të dhënat nga intervistat dhe diskutimet në fokus grupe me anëtarët e KVSP-së tregojnë se bashkëpunimi ndër-institucional, komunikimi dhe koordinimi ka qenë një ndër sfidat më të mëdha për mungesën e efektivitetit të mekanizmit. Të intervistuarit raportojnë se koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional janë një proces i vështirë dhe sfidues duke qenë se mungon në përgjithësi informacioni që përfaqësuesit e institucioneve duhet të kenë mbi përgjegjësitë, rolin e tyre dhe pjesëmarrjen në KVSP. Ndonëse pjesëmarrësit evidentojnë praktika pozitive në lidhje me komunikimin zyrtar për caktimin e pikave fokale në KVSP nga institucionet, marrja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia e institucioneve përgjegjëse ka qenë një pikë e dobët, kjo për shkak edhe të lëvizjeve të shpeshta të stafit nga institucionet pjesëmarrëse në KVSP. Një tjetër anëtar i KVSP-së shprehet se ndërrimi i herëpashershëm i stafit bëhet akoma më problematik në mungesë të qartësisë të roleve dhe përgjegjësisë të aktorëve të përfshirë:

*Ne jemi të gjithë të rinj dhe nuk kemi qenë pjesë e këshillit kur është themeluar. Është problematik fakti i ndërrimit të stafit, pasi kur ndërrohen aktorët duhet të ketë dokumente strategjike që flasin për rolet e gjithsecilit në këtë strukturë. Për kaq kohë sa kemi ardhur jemi munduar të marrim pjesë në mbledhjet që bëhen për rendin dhe sigurinë publike dhe jemi shumë të hapur për mundësitë dhe mbështetjen që do të na vijjnë nga organizata të shoqërisë civile për ta fuqizuar më tej rolin e KVSP-së. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

**Ndryshimet e shpeshta tek anëtarët e KVSP-së, ndikojnë në njëfarë mase në pjesëmarrjen jo të rregullt të tyre në mbledhjet e KVSP-së, humbjen e memories institucionale, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin në përgjigje të çështjeve të referuara dhe ruajtjen e kapaciteteve në nivelin institucional.**

Një anëtare e hershme e KVSP-së evidenton sfidat e ndërrimi të shpeshtë të stafeve në KVSP:

*Unë dhe një kolege kemi qenë që në fillimet e grupit të punës, por sot nuk shoh asnjë nga ato që kanë qenë në fillim me ne, sepse janë ndryshuar. Si mund të punojmë kështu? Sa herë ndryshojnë personat, sepse nëse ndryshohen kaq shpesh çdo herë fillon nga fillimi. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i OSHC)*

Një fenomen i tillë krijon, gjithashtu, trysni mbi anëtarët ekzistues për të vendosur kontakte me stafin e emëruar rishtas, trajnimin e tyre për funksionet KVSP-së, legjislacionin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në KVSP.

Në përgjithësi, vlerësohet se anëtarët e KVSP-së nuk janë të informuar qartësisht për rolin dhe funksionin e tyre institucional në KVSP si dhe përgjegjësitë e tyre nuk janë përfshirë në përshkrimet e tyre të punës.

**Pavarësisht se institucionet e qeverisjes vendore kanë ndërvepruar në rrugë formale dhe jo formale edhe në kuadër të funksionimit të mekanizmave të tjerë vendorë, ndërveprimi si anëtarë të KVSP-së nuk ka rezultuar në ndonjë angazhimin për marrjen e përgjegjësisë të përbashkëta si dhe në krijimin e partneriteteve të qëndrueshme për pjesën dërrmuese të bashkive. Mungesa e bashkëpunimit dhe procedurat jo të qarta për dhënien e informacionit periodik në lidhje me çështjet e diskutuara në KVSP reflektohet në komunikimin e fragmentuar dhe jo efikas. Kjo ka penguar më tej efikasitetin e funksionimit të një mekanizmi të tillë, pasi nuk është arritur të krijohet një kohezion dhe sinergji mes anëtarëve të KVSP-së. Megjithatë evidentohen edhe raste pozitive në disa bashki, të cilat kanë pasur anëtarë më të qëndrueshëm, gjë që kontribuon në funksionimin e tyre të mirë.**

Një pjesëmarrëse nga fokus grupet shprehet se për të krijuar një model efektiv dhe operacional, duhet që angazhimet të mos ngelen thjesht në letër, por të merren përgjegjësi të përbashkëta dhe të monitorohet vazhdimësia.

*Kam marrë pjesë tek takimi që keni bërë më parë i KVSP-së. Takimi u realizua dhe diskutuam për çështje më rendësi, por shumë gjëra ende nuk i kam parë të realizohen.*


*Mungon monitorimi dhe raportimi për çështjet që kemi diskutuar dhe sa janë realizuar. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

## Kapacitetet teknike të institucioneve anëtare në KVSP

Të dhënat e sondazhit me punonjësit e bashkisë raportojnë se pjesa dërrmuese e të pyeturve (95%) shprehen se kanë nevojë për rritje të vazhdueshme kapaciteteve për anëtarët e KVSP-së. Në nivel vendor, veprimtaritë për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVSP-së dhe fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit mbi rolin e këtyre mekanizmave realizohen më së shumti në bashkëpunim me partnerë/donatorë për zhvillim dhe me OSHC-të. Tipologjitë e trajnimeve variojnë nga trajnime mbi kuadrin ligjor dhe institucional, rritjen e kapaciteteve për identifikimin, në ato për vlerësimin e nevojave për fëmijët e pashoqëruar nga vendet e treta, për viktimat e dhunës etj. Megjithatë, lëvizja e shpeshtë e stafit krijon ndërprerje të përkohshme në funksionimin e KVSP-ve dhe kërkon trajnime të vazhdueshme për t'u njohur me rolin dhe funksionin e tyre në KVSP si dhe me procedurat e punës.

Në vijim të anketuarit u pyetën nëse gjatë dy viteve të fundit kanë marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë trajnim për funksionimin e KVSP-së dhe të dhënat në Figurën 10 tregojnë që më shumë se gjysma e të anketuarve, përkatësisht 63.6% kanë pohuar se kanë marrë pjesë, ndërsa pjesa tjetër (36.4%) kanë thënë 'Jo'. Evidentohet nevoja për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me çështjet për fëmijët në konflikt me ligjin, çështjet e sigurisë publike si dhe trajnime që rrisin kapacitetet operacionale të anëtarëve të KVSP-së.


Figura 10. Në dy vitet e fundit a keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë trajnim mbi funksionimin e KVSP-së?



Përsa i përket mendimit lidhur me rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVSP-së, pothuajse të gjithë e vlerësojnë të rëndësishme rritjen e kapaciteteve, përkatësisht 77.3% e vlerësojnë si 'shumë të rëndësishme' dhe 18.2% si 'të rëndësishme'. Vetëm një nga të pyeturit gjykon se rritja e kapaciteteve ka 'pak rëndësi'. **Një qasje proaktive në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike kontribuon në rritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, motivimit dhe në maksimizimin e punës së përbashkët dhe kjo reflektohet edhe nga të dhënat sasiore të përftuara**

**nga studimi ku 95.5% e të anketuarve e vlerësojnë rritjen e kapaciteteve si një aspekt të rëndësishme, ose shumë të rëndësishëm.**

Figura 11. Sa të rëndësishme e vlerësoni rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVSP-së?



### Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rolin dhe funksionimin e KVSP-së

**Pjesëmarrësit në fokus grupe deklarojnë se nuk realizohen mjaftueshëm takime informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere për rolin dhe funksionimin e KVSP-së, apo për ndërgjegjësimin e komunitetit në territorin e bashkisë.** Në kuadër të fushatave ndërgjegjësuere, përfaqësuesit e institucioneve vendore kanë organizuar takime me komunitetin në njësitë administrative duke bashkëpunuar me shoqatat vendore për ditë të veçanta sensibilizuese, duke kryer aktivitete të përbashkëta ndërgjegjësuere në lidhje me sigurinë në komunitet. **Të intervistuarit shprehën se komuniteti shpeshherë është apatik si në procesin e raportimit të ngjarjeve kriminale por edhe në proceset e pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje. Në këtë kontekst, duhet më shumë përpjekje për të ndërgjegjësuar qytetarët që të denoncojnë mosmarrëveshje që mund të çojnë në krime më të rënda, por edhe institucionet të jenë më aktive në parandalim.**

*Bashkitë ndryshojnë nga njëra tjetra. Mendësia dhe kultura e komunitetit ndryshojnë në bashki të ndryshme. Çdo gjë duhet të nisët dhe nga kultura dhe mentaliteti i komunitetit me të cilin do punoni. Duke mos pasur këtë angazhimin qytetar që mungon, unë kam 18 vite në bashki dhe nuk mbaj mend të kemi pasur një reagim qytetar për gjërat që me të vërtetë e shqetësojnë komunitetin. Edhe kur reagimet nuk vijnë nga qytetarët, atëherë këto takimet tona këtu janë informale. Kthehen në informale, sepse ti nuk ke një person që të godet ty qoftë si shërbim arsimor, bashki, shërbim social, nuk të godet aty ku ti e ke problemin dhe ne rrimë pushojmë në këtë nivelin tonë. Njëra është bashki më e madhe kurse tjetra është më e vogël.*

*Këtu njihen të gjithë dhe është shumë e vështirë prej njohjeve që të raportohet diçka dhe nëse sheh një abuzim, apo një minoren që i jep makinës s'e raporton dot se mund t'i njohësh familjarët, ose ai ka familjarë në bashki apo polici. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve arsimore)*

Të dhënat e përfituara nga profesionistët në lidhje me perceptimet që ata/o kanë mbi funksionimin dhe rolin e KVSP-së në ruajtjen e sigurisë publike, tregojnë se 60.8% e profesionistëve janë dakord me pohimin që 'KVSP-ja është mekanizmi më efikas në nivel vendor për të adresuar sfidat e sigurisë publike', përkatësisht 'dakord' dhe 'plotësisht dakord' me 30.4%

secila. Gjithashtu, shumica dërrmuese e profesionistëve, përkatësisht 73.9% bien dakord që ‘KVSP-ja luan një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe menaxhimin në nivel vendor të problematikave që lidhen me sigurinë në komunitet’, respektivisht 26.1% janë ‘dakord’ dhe gati gjysma, me 47.8%, janë ‘plotësisht dakord’. Së fundmi, 60.8% (21.7% ‘dakord’ dhe 39.1% ‘plotësisht dakord’) e profesionistëve besojnë që ‘KVSP-ja nxit transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve vendore ndaj çështjeve të sigurisë publike’.

Tabela 1. Perceptimet mbi funksionimin dhe rolin e KVSP në komunitetet vendore

Pohimet	2	3	4	5 – Plotësisht dakord
a. KVSP është mekanizmi më efikas në nivel vendor për të adresuar sfidat e sigurisë publike	0%	30.4%	30.4%	30.4%
b. KVSP-së luan një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe menaxhimin në nivel vendor të problematikave që lidhen me sigurinë në komunitet	4.3%	13.0%	26.1%	47.8%
c. KVSP nxit transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve vendore ndaj çështjeve të sigurisë publike	8.7%	26.1%	21.7%	39.1%

Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në fokus grupe ishin të mendimit se funksionimi i duhur dhe efikas i KVSP-ve do të ndihmonte në uljen e intensitetit dhe në eliminimin gradual të dukurive negative që kërcënojnë sigurinë publike dhe në veçanti grupet më të cenueshme.

## Raportimi dhe monitorimi

**Nismat aktuale për të rigjallëruar KVSP-të në disa bashki të vendit nuk janë të mjaftueshme, nëse nuk shoqërohen me buxhetim të mjaftueshëm, me mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave periodike, të planeve shumaktoriale vendore dhe me tregues të matshëm për monitorimin dhe vlerësimin e performancës.** Një tjetër përfaqësues i institucioneve vendore deklaroi se efikasiteti i KVSP-së arrihet vetëm nëse ka tregues të matshëm të performancës, çka është edhe një tregues i qartë i llogaridhënies te qytetarët.

*Ekziston një mendim se teksa janë krijuar këto këshilla në Shqipëri kanë një aureolë simbolizmi. Pra bëhen për të kaluar radhën. E ky perceptim nuk ndodh rrallë, ndodh*

*shpesh. Ka shumë institucione vendore publike që mbledhen sa për ta bërë. E nuk është ky qëllimi. Po pse nuk është ky qëllimi nëse thelbi është policimi në komunitet? Si e angazhojmë ne komunitetin? Brenda detyrave funksionale që ka policia apo bashkia? Nëse ky është prioriteti dhe komuniteti nuk ka besim është e kotë të krijosh mekanizma. Atëherë brenda kësaj agjende duhet të vendosen disa KPI, **tregues të performancës**, të cilët në fillim mund të jenë referues, por po nuk u zbatuan ato, pra nëse qytetarët deklarojnë një X numër krimesh që duhet të ndiqen në nivel vendor dhe në fund të vitit nuk bëhet asgjë, mos prit që vitin tjetër të ketë efektivitet ky plan. Pra, llogaridhënia tek qytetarët duhet të vijë si fillim duke marrë informacion se çfarë i shqetëson ato, çfarë kanë ato prioritet? Por një vit më vonë duhet të vijë dhe me një raportim të detajuar se çfarë është bërë për këto shqetësime përveçse kemi vëzhguar. E kjo përmbush dhe karakterin ciklik të çdo viti. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

**Pra, sikurse evidentohet edhe nga deklarata më sipër agjenda e sigurisë publike krijohet me qytetarët (ata pyeten se çfarë i shqetëson) dhe sërish institucionet japin llogari para qytetarëve (ku kemi arritur dhe sa i kemi adresuar prioritetet tuaja). Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në planin shumëaktorial të veprimit, mungesa e treguesve të matshëm pengon procesin e monitorimit të vazhdueshëm të veprimitarisë së këtyre strukturave, që konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale të zbatimit të masave në plan. Transparenca e vetë procesit të hartimit të prioriteteve vendore të sigurisë publike, e më tej, llogaridhënia në trajtimin e problematikave shqetësuese ndikojnë në rritjen e shkallës së besimit të qytetarëve tek KVSP në çdo bashki.**



## SEKSIONI III. QASJA SHUMAKTORIALE DHE PARTNERITETET E QËNDRUESHME



## Qasja shumaktoriale

Në këtë rubrikë të pyetësorit profesionistët janë pyetur në lidhje me perceptimet që ata/ato kanë për përfshirjen e qytetarëve dhe institucioneve vendore. Në Tabelën 2 më poshtë paraqitet niveli i dakordësisë për një sërë pohimesh, në shkallë me pesë pikë nga 1 (aspak dakord) në 5 (plotësisht dakord).

Të dhënat sasiore tregojnë se 69.5% e profesionistëve janë dakord me pohimin që *'partneriteti mes institucioneve të përfshira në KVSP rrit besimin publik dhe garanton qëndrueshmëri të KVSP-së'*, respektivisht 39.1% janë 'dakord' dhe 30.4% janë 'plotësisht dakord'. Gjithashtu, shumica dërrmuese e profesionistëve, përkatësisht 87% ('dakord' dhe 'plotësisht dakord' me 43.5% secila), janë të mendimit që *'veprimtaria e KVSP-së do të ishte më efektive nëse mbështetet në partneritetin dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm mes bashkisë, policisë dhe prokurorisë'*. Së fundmi, 69.1% (39.1% 'dakord' dhe 34.8% 'plotësisht dakord') e profesionistëve besojnë që 'Qasja shumëktoriale e KVSP adreson në mënyrë efektive çështjet e sigurisë së komunitetit dhe fenomenet e reja si ekstremizmi i dhunshëm, riintegrimi i grupeve të cenueshme, flukset migratore, etj.'


Tabela 2. Ju lutem shprehni dakordësinë tuaj për sa i përket pohimeve si më poshtë në lidhje me KVSP

Pohimet	2	3	4	5 – Plotësisht dakord
b. Partneriteti mes institucioneve të përfshira në KVSP (Bashki, Prokurori dhe Polici si dhe bashkëpunimi me qytetarët, shkollat, institucionet publike në nivel vendor OSHC) rrit besimin publik dhe garanton qëndrueshmëri të KVSP	0%	21.7%	39.1%	30.4%
c. Qasja shumaktoriale e KVSP adreson në mënyrë efektive çështjet e sigurisë së komunitetit dhe fenomenet e reja si ekstremizmi i dhunshëm, riintegrimi i grupeve të cenueshme, flukset migratore, etj.	4.3%	13.0%	39.1%	34.8%
d. Veprimtaria e KVSP-së do të ishte më efektive nëse mbështetet në partneritetin dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm mes bashkisë, policisë dhe prokurorisë	0%	4.3%	43.5%	43.5%

Po ashtu të anketuarit janë pyetur në një shkallë me pesë pikë nga 1 (aspak dakord) në 5 (plotësisht dakord) në lidhje me rëndësinë e rolit të një sërë institucioneve dhe aktorësh në funksionimin e KVSP-së. Ndonëse të dhënat sasiore të përfituara nga pyetësori tregojnë se në përgjithësi roli i të gjithë institucioneve dhe aktorëve të përfshirë është shumë i rëndësishëm në KVSP, disa institucione perceptohen se kanë një rol disi më të rëndësishëm në raport me institucionet apo aktorët e tjerë. Institucionet kryesore të renditura me % më të madhe janë

:policia ( 90.5 %) prokuroria ( 90.5%); ndjekur nga shoqëria civile, qeveria lokale -bashki/ njësi administrative, dhe institucionet arsimore ( 85.7%).

Figura 12. Përshtatshmëria dhe rëndësia e rolit të secilit prej institucioneve/aktorëve të mëposhtëm në KVSP



Diskutimet në fokus grupe nxorën në dritë disa dinamika dhe sfida të tjera në lidhje me përfshirjen e institucioneve apo aktorëve vendorë në KVSP. Përtej bashkëpunimit ndër-institucional, personat e anketuar vunë theksin tek roli i angazhimit të qytetarëve në parandalimin e krimit dhe të situatave të tjera që cenojnë sigurinë publike. Të intervistuarit theksuan se takime të tilla krijojnë afërsi më të madhe me qytetarët për trajtimin e problematikave të komunitetit. Kjo jo vetëm e bën procesin shumaktorial dhe gjithëpërfshirës, por nga ana tjetër siguron përgjegjshmërinë e institucioneve ndaj qytetarëve. Ndonëse pjesëmarrësit vlerësojnë si shumë të rëndësishëm rolin e secilit prej institucioneve të përfshira në KVSP, pjesëmarrja e qytetarëve siguron një vetpronësi dhe llogaridhënie më të lartë, siç tregohet nga një pjesëmarrës në fokus grupin si më poshtë.

*Unë mund të flas dhe ta ngre zërin, por flas si institucion për punën që bëj dhe mbroj punën time. Nuk mund të jem zëri i qytetarëve. Qytetari duhet të vijë me të vërtetë për atë që ai vuan në kurriz të tij. Mekanizma ka sa të duash, por i pari është ndërgjegjësimi i qytetarëve. Ju sugjeroj ta filloni punën duke përfshirë komunitetin, duke e ndërgjegjësuar atë më shumë. (Pjesëmarrëse e një fokus grup, bashki në veri)*

Rritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në KVSP ndihmon jo vetëm në identifikimin dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale, por i bën ata “lojtarë” të rëndësishëm në ndryshimin e situatës për nisjen dhe ndërtimin e një sistemi më funksional dhe efektiv për mirëqenien dhe sigurinë e komuniteteve vendore.

Përvoja në terren e IDM-së në 20 bashki të vendit tregon se takimet e hapura me qytetarët janë ndër instrumentet më të rëndësishëm për të jetësuar punën e KVSP-së dhe për t'i bërë ata partnerë në hartimin e agjendës dhe politikave vendore të sigurisë publike. Këto takime mund të konsiderohen instrumente gjithëpërfshirës që mbështeten në filozofinë e partneritetit dhe njëherazi ofrojnë një qasje nga poshtë-lart përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve.

Takimet llogaridhënëse dëshmojnë se janë shumë të rëndësishme për institucionin e kryetarit të bashkisë, por edhe të Këshillit Bashkiak, sepse sjellin ndjeshmëri konkrete për përgjegjësinë e tyre në sigurinë publike. Modeli i takimeve të hapura për parandalimin e krimit përmes angazhimit të qytetarëve krijon mundësi unike për të ndikuar nga poshtë-lart, mbështetur në sfidat dhe perceptimet e qytetarëve për sigurinë, sikundër ofrojnë një mundësi shumë të mirë për të nxitur reagimin proaktiv të të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë edhe qytetarët.<sup>6</sup>

**Përfshirja aktive e qytetarëve në takimet e hapura konsultative çon në institucionalizimin e një kulture llogaridhënieje të institucioneve vendore duke rritur kështu ndërgjegjen kolektive. Një llogaridhënie e tillë nxit debatin në nivel vendor për sigurinë, që nga ana e saj ndikon në ndryshimin e mentalitetit shoqëror mbi përgjegjësinë e përbashkët dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Raporte studimore tregojnë se organizimi rregullisht i takimeve të hapura me komunitetin përmirëson zbatimin e ligjit në nivel vendor, rrit komunikimin e institucioneve me qytetarin, rrit besueshmërinë e publikut si dhe përmirëson përgjegjshmërinë e institucioneve.<sup>7</sup>**

## **Qasja e orientuar sipas nevojave të kontekstit vendor**

Duke qenë se bashkitë përballen me sfida dhe dinamika të ndryshme, konteksti vendor dikton edhe qasjen që duhet të ndiqet nga KVSP për të adresuar sfidat e sigurisë në nivel vendor. Në përgjithësi, ka një konsensus nga të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupe se KVSP është një mekanizëm gjithëpërfshirës që i shërben sigurisë së komunitetit, por dinamikat dhe sfidat e sigurisë ndryshojnë nga një bashki në tjetrën. **Për të qenë sa më funksional mekanizmi duhet të ngrihet dhe funksionojë duke iu përshtatur kontekstit të bashkive dhe dinamikave të komuniteteve vendore. Në varësi të dinamikave lokale bashkitë mund të përballen me fenomene nga më të ndryshme, të tilla si të miturit në konflikt me ligjin, dhuna, bullizmi, diskriminimi, shantazhet dhe krimet kibernetike, flukset e migrantëve nga vendet e treta, të kthyerit nga zonat e konfliktit apo dukuri të tjera problematike për qytetarët.**

Në këtë kontekst, një përfaqësues nga institucionet vendore deklaroi se ndonëse në bashkinë ku ai punon ka një sërë çështjesh që funksionojnë shumë mirë dhe menaxhohen në mënyrë efektive nga struktura të tjera vendore, ka fenomene të reja të cilat mund të përbëjnë kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë publike siç është zjarrvënja, fenomen i cili ka një komponent komunitar.

---

<sup>6</sup> IDM. (20220). Buletin Nr. 5 Integritet Llogaridhënie Partneritet.

<sup>7</sup> IDM. (20220). Buletin Nr. 5 Integritet Llogaridhënie Partneritet.

*Ka disa komponent që ne si bashki i bëjmë dhe i bëjmë shumë mirë për sa i përket sigurisë publike. Ka disa të tjerë të cilat nuk janë të integruara në një plan veprimi që nuk na lëviz bashkëpunimin dhe me struktura të tjera dhe me komunitetin. Në vitet e fundit është rritur rëndom numri i zjarrvënieve të qëllimshme. Ka një komponent komunitar. Njerëzit duhet të kenë informacion se kush e ka bërë, kurse për ne si bashki kthehet në problem logjistik, por dhe problem rendi apo sigurie publike. Raste të ngjashme mund të ketë shumë. Sugjerimi im është ky: ne për vitin e ardhshëm do të bëjmë një takim të shkurtër me kryetarin duke ardhur me një propozim për ta integruar punën e vitit të ardhshëm dhe në strukturat e bashkisë dhe e kemi një rrugëtim se si bëhet kjo gjë. (Pjesëmarrës në fokus grupin e datës 23.12.23)*

### **Bashkërendimi me mekanizmat e tjerë vendor**

**Në shumicën e bashkive, anëtarët e KVSP-së janë deri diku të njëjtë me anëtarët e ETN - Ekipi Teknik Ndërdisciplinor si dhe ata të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve. Kjo nxit nevojën për krijimin e një mekanizmi më gjithëpërfshirës për të bashkërenduar punën e përbashkët me qëllim maksimizimin e ndikimit të punës, sikurse evidentohet nga një pjesëmarrëse në fokus grup.**

*Duhet që pushteti vendor e qendror dhe shoqëria civile të bëhemi bashkë për të vendosur për gjërat që mungojnë apo planet që mungojnë. Paralelisht me këtë takim që ne po bëjmë sot në lidhje me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike na kërkohet të bëhet dhe takimi për mekanizmin e rasteve të dhunës. Nëse do t'i marrim këto të dy mekanizma të veçantë, do të nisen si të tillë, por do dalin si të përbashkëta. Sepse na ka ndodhur që dhe në rastet e mbledhjes të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike të trajtohen çështje të dhunës në familje dhe duke qenë në të tilla pozita mendoj se fillojmë të shpërndahe mi dhe kur ndodh kjo nuk arrin të bësh dot asnjërin as tjetrën pasi do të kesh mangësi në të dyja gjërat. Për mua kjo është shumë e rëndësishme nëse do të nisemi nga prioritetet e qytetarëve. Bashkia e ka shumë të lehtë të nxjerrë prioritetet e qytetarëve dhe atyre që lidhen me sigurinë publike. P.sh. një element që ne na trajtohet në dëgjësat tona publike është ndriçimi i rrugëve apo akseve nëpër lagje në mënyrë që të rritet siguria, që qytetarët të mos kenë më frikë për vjedhje në banesat e tyre dhe ne duke e marrë si pjesë të dëgjësave publike e zgjidhim këtë gjë. Duhet të jemi të kujdesshëm që hartimi i një plani për sigurinë vendore të mos krijojë mbivendosje me planet e tjera vendore. (Pjesëmarrës i DFG, përfaqësues i institucioneve vendore)*

**Ndërsa ekzistojnë shumë mekanizma dhe struktura për sigurinë dhe mbrojtjen në nivel vendor, mungesa e një mekanizmi të integruar vendor për më gjithëpërfshirës, si dhe komunikimi i kufizuar institucional mes të gjithë palëve kryesore lokale, bën që koordinimi për menaxhimin e çështjeve të sigurisë të jetë disi i fragmentuar. Deri më tani, përvoja ka treguar se një qasje e integruar shumaktoriale në nivel vendor do të ishte efektive jo vetëm në trajtimin e**

**kërcënimeve të vazhdueshme që lidhen me zbatimin e ligjit dhe sigurinë publike, por edhe në parandalimin e dukurive të tjera, si radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.**

Strukturat dhe mekanizmat e vendor të themeluara në bashki, siç janë Njësitet për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), Grupi Teknik Ndërsektorial dhe Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR) janë mekanizmat kyçë për vlerësimin, identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të mundshme (përfshirë edhe fëmijët dhe familjet në rrezik). Këto struktura hasen me sfida për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike, financiare dhe njerëzore. Për më tepër, NJMVR është një strukturë e re, e pilotuar në disa bashki të tjera dhe ende nuk është vënë përfundimisht në punë dhe në fund GTN ka një koordinim disi të fragmentuar në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe në kohë për grupet më të cenueshme dhe ato të marginalizuara. Po ashtu, Këshilli Rinor Vendor në bashki, ka nevojë për kapacitete njerëzore dhe teknike për të qenë sa më funksional.

**Koordinimi midis mekanizmave ekzistues në nivel vendor, përfshirë këtu edhe KVSP-në, nuk është në nivelin e duhur, pasi strukturat veprojnë deri diku të shkëputura me njëra tjetrën dhe nuk krijojnë sinergji për një komunikim më të koordinuar dhe gjithëpërfshirës për çështje të cilat mund të kenë një emërues të përbashkët “sigurinë e qytetarëve”.**

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME



## PËRFUNDIME

Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike janë mekanizma këshillimorë të ngritura në çdo bashki me qëllim hartimin e politikave gjithëpërfshirëse të veprimit që kontribuojnë në rritjen e sigurisë publike në nivel vendor. Konceptimi i KVSP dhe kompetencat e bashkisë dhe institucioneve të tjera në kuadër të KVSP revizionojnë keqkuptimin se vetëm punonjësi i policisë, prokurori dhe/ose gjykatësi mund të ndikojnë në uljen e krimit dhe të rrisin sigurinë në komunitet. Konceptimi, standardizimi dhe vlerësimi i sigurisë publike kërkon përcaktimin e qartë të rolit të çdo aktori dhe moslënien “në hije” të asnjë institucioni, aktori apo pale të përfshirë. Roli i qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe, në veçanti, i të rinjve mbetet vendimtar në proceset parandaluese dhe ruajtjen e sigurisë publike. Standardet e Kombeve të Bashkuara Publike janë mekanizma këshillimorë, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian<sup>8</sup> promovojnë një zgjidhje të ndryshme. Partneriteti është një parakusht i domosdoshëm për parandalimin efektiv të krimit dhe përmirësimin e sigurisë publike. Qëllimi është të ndërtojmë komunitete të sigurta dhe kjo nënkupton një punë të përbashkët aktive brenda partneritetit të aktorëve të ndryshëm në nivel lokal, me synimin për të parandaluar dhunën dhe aktivitetet e krimit, si dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve. Modeli i Bashkisë së Elbasanit i trajtuar pikërisht mbështetet në partneritetin horizontal të institucioneve vendore dhe në përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në ndërtimin e një axhendë vendore të sigurisë.

- ***Kuadri rregullator i funksionimit të KVSP-ve:*** KVSP-të funksionojnë formalisht, ndonëse jo efikase. Mungesa e një rregulloreje “tip” apo “standart” që përcakton qartë institucionet pjesëmarrëse, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë në strukturë nuk ofron një qasje të integruar për trajtimin e çdo kërcënimi ndaj sigurisë. Paqartësia e procedurave të brendshme dhe mungesa e një metodologjie të qartë dhe të unifikuar për identifikimin, analizimin dhe raportimin e risqeve të sigurisë në çdo bashki mund të bëhet pengesë për të adresuar në kohë rreziqet, duke zbehur deri diku rolin parandalues të këtij mekanizmi. Këto aspekte padyshim që vështirësojnë qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e punës së KVSP-së. Rregullorja e KVSP Elbasan dhe praktika pozitive e funksionimit të këtij mekanizmi, mund të shërbej si një model referues për të hartuar kuadrin rregullator të KVSP-ve, e cila do të përshtatet nga çdo KVSP sipas kontekstit lokal.

***Mangësitë e kuadrit rregullator të konsoliduar shkaktajnë mungesë efikasiteti për funksionimit të KVSP-së.*** Në praktikën e deritanishme të funksionimit të KVSP-ve ende mungon procedura e vlerësimit institucional për veprimtarinë shumaktoriale të KVSP-ve. Po ashtu, edhe pse disa organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë janë përpjekur herë pas here të asistojnë për t’i rigjallëruar dhe riaktivizuar KVSP-të, ato nuk kanë arritur të krijojnë një vazhdimësi për funksionimin efikas të mekanizmit dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve. Këto nisma nuk janë të mjaftueshme nëse nuk shoqërohen

---

<sup>8</sup> ECOSOC Resolution 2003/26 – Prevention of urban crime; ECOSOC Resolution 2006/20 – United Nations standards and norms in crime prevention; ECOSOC Resolution 2007/12 – Strategy for the period 2008-2011 for the United Nations Office on Drugs and Crime; ECOSOC Resolution 2008/24 – Strengthening prevention of urban crime: an integrated approach; Recommendation No. R (87) 19 of the Committee of Ministers to Member States on the Organisation of Crime Prevention; Resolution 160 (2003) on local partnership for preventing and combating violence at school; Council Decision 2009/902/JHA of 30 November 2009 setting up a European Crime Prevention Network (EUCPN) and repealing Decision 2001/427/JHA.



me buxhet të mjaftueshëm, me mbledhjen dhe ndarjen rregullisht të të dhënave, me plane shumaktoriale vendore dhe me tregues për monitorimin dhe vlerësimin e performancës. Disa arsye për efikasitetin e ulët të këtij mekanizmi janë mungesa e protokolleve dhe procedurave standarde të veprimit, mungesa e instrumenteve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave si dhe dokumentimin e mbledhjeve, mangësitë në burime njerëzore, financiare, infrastruktura e dobët dhe shërbime mbështetëse të kufizuara. Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në planin shumaktorial të veprimit, mungesa e treguesve të matshëm pengon procesin e monitorimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së këtyre strukturave, proces që konsiderohet i nevojshëm për të analizuar situatën reale të zbatimit të masave të përcaktuara në plan.

- **Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit** në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të ruajtjes së konfidencialitetit apo të ndjeshme përmirëson funksionimin e mekanizmit. Administrimi i informacionit në mënyrë profesionale jo vetëm që ul rrezikun e stigmatizimit të komunitetit/eve po edhe mundëson shmangien e sjelljeve diskriminuese ndaj një grupimi, komuniteti a bashkësie të caktuar. Për më tej, në rastet e trajtimit të çështjeve të rëndësishme të sigurisë publike, me karakter të fshehtë dhe të ndjeshëm, detyra e çdo anëtarit të KVSP është të respektojë parimet etike dhe legjislacionin në fuqi për respektimin e parimeve të konfidencialitetit.
- **Koordinimi dhe bashkëpunimi shumaktorial:** përmes procedurave të qarta, të dakordësuara dhe të miratuara për rolet dhe përgjegjësitë institucionale mund të arrihet një bashkëpunim horizontal mes aktorëve të ndryshëm. Koordinimi dhe bashkëpunimi shumaktorial kërkon gjithashtu vullnet të lidërshiptit të institucioneve. Ndryshimet e shpeshta të anëtarëve të KVSP-së ndikojnë në një farë mase në pjesëmarrjen jo të rregullt të tyre në mbledhjet e KVSP-së, në humbjen e memories institucionale, në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin në përgjigje të çështjeve të referuara dhe në ruajtjen e kapaciteteve në nivel institucioni. Mungesa e ndjekjes dhe raportimit në vijimësi të masave të dakordësuara dobëson mekanizmin dhe ul gjasat për sukses të praktikave të mira. **Prezantimi i modelit të “trekëndëshit institucional” të ndërveprimit bashki-polici-prokurori** orienton drejt një efikasiteti më të lartë të planeve të veprimit dhe të masave konkrete për parandalimin e krimit dhe për sigurinë publike përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrja aktive e prokurorisë i jep besueshmëri më të madhe procesit, pasi krijon një hapësirë më të gjerë komunikimi që ka të bëjë me edukimin ligjor të të rinjve dhe informimin publik në lidhje me statistikat dhe tendencat vendore të veprimtarisë kriminale si mjet parandalimi. Megjithatë, riorganizimi që ka ndodhur së fundmi në organin e prokurorisë mund të kufizojë përkohësisht pjesëmarrjen e rregullt të institucionit në këtë partneritet. Edhe pse prokuroria mbështet përpjekjet për parandalimin e krimit dhe sjell vlera në këtë partneritet, për shkak të riorganizimit të prokurorisë angazhimi i këtij institucioni mund të konsiderohet sipas rastit nga vetë institucioni i prokurorisë dhe konteksti i bashkisë.

- ***Bashkëndimi me mekanizmat e tjerë vendorë:*** Ekzistenca e mekanizmave tematikë vendorë, si Mekanizmi Kundër Dhunës në Familje apo Grupet Teknike Ndërsektoriale, evidentojnë nevojën për një kulturë institucionale për të bashkëpunuar punën me qëllim maksimizimin e ndikimit. Si mekanizëm gjithëpërfshirës, KVSP është një përpjekje për institucionalizimin e një modeli efektiv të bashkëpunimit dhe partneritetit horizontal, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë mes të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë koordinimin dhe qasjet e bashkëpunimit me strukturat dhe mekanizmat e tjerë në nivel vendor. Në këtë mënyrë, krijohet një perspektivë për një përgjigje më të shpejtë dhe të koordinuar.
- ***Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të anëtarëve të KVSP:*** për shkak të ndryshimit të herëpashershëm të stafëve vendore, ndryshimit të strukturave vendore, shtimit/kufizimit të burimeve dhe kapaciteteve njerëzore, anëtarësia në KVSP nuk është e qëndrueshme. Ky fakt ka krijuar ndërprerje të përkohshme në funksionimin e KVSP-ve, mungesë të informimit dhe evidentimin e nevojave emergjente për trajnime të vazhdueshme për kuadrin rregullator dhe institucional të KVSP-ve, rritjen e kapaciteteve për identifikimin, vlerësimin e nevojave, për fëmijët e pashoqëruar nga vendet e treta, për viktimat e dhunës bullizmin, përdorimin e substancave, çështjet e sigurisë publike, të rikthyerit nga zonat e konfliktit, apo ndikimi i flukseve migratore, etj. si dhe nevojë për më shumë fushata ndërgjegjësuere dhe rol proaktiv të aktorëve vendorë (si p.sh., OSHC-të) në këtë mekanizëm. Qasja proaktive në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore kontribuon në rritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, motivimit dhe në maksimizimin e punës së përbashkët. Fuqizimi i institucioneve anëtare në KVSP, ndërgjegjësimi dhe informimi institucional i të gjithë aktorëve për rolin e këtyre pikave fokale në nivel vendor rrit qëndrueshmërinë e mekanizmit, ndihmon në vendosjen e urave të komunikimit dhe identifikon zgjidhje dhe rrit besimin e komuniteteve.
- ***Ndërgjegjësimi dhe informimi mbi rolin e KVSP:*** Fuqizimi i rolit proaktiv të qytetarëve në funksionimin e KVSP-ve mbetet thelbësor. Mungesa e përfshirjes së tyre në procesin e identifikimit të shqetësimeve kryesore të sigurisë krijon hendek të thellë në komunikimin horizontal mes institucioneve dhe qytetarëve. KVSP-të funksionojnë si një mekanizëm i përhershëm pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në funksionin e tyre si hallka kyçe që *“kujdesen për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve”* dhe përgjegjëse për garantimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies sociale të qytetarit. Pjesëmarrja qytetare konsolidon praktikat institucionale dhe forcon qëndrueshmërinë e komuniteteve ndaj çdo dukurie negative që kërcënon sigurinë publike. Kjo pjesëmarrje, nga ana tjetër, siguron një pronësi të procesit dhe llogaridhënie më të lartë. Një llogaridhënie e tillë nxit debatin në nivel vendor për sigurinë, që nga ana e saj ndikon në ndryshimin e mentalitetit shoqëror mbi përgjegjësinë e përbashkët dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe qytetarëve. Përcaktimi dhe konsultimi publik i hartës së rreziqeve ndaj sigurisë publike, në përputhje me veçoritë/dinamikat dhe njohjen e problematikave që shqetësojnë komunitetet vendore, sigurisht që fuqizon këtë mekanizëm të rëndësishëm vendor.

Për të patur pjesëmarrje aktive është e rëndësishme që qytetarët të jenë të informuar dhe ndërgjegjësuar në lidhje me procesin, rëndësinë e hartës së rreziqeve të sigurisë publike. Pjesëmarrja aktive në KVSP, sikundër përshkruhet në gjetjet studimore, garanton përgjigje në kohë reale dhe profesionalisht shteruese për çdo kërcënim të mundshëm që lind brenda komuniteteve. Është në të mirë të komuniteteve që rolet dhe përgjegjësitë të jenë të përcaktuara dhe të mbështetura në të dhëna, konsultimet publike të jenë të hapura dhe transparenca të jetë e garantuar. Vetëm në këtë mënyrë, KVSP-ve i jepet zëri “i munguar” pranë komuniteteve dhe arrihet garantimi i parimeve demokratike të pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirjes për çdo aktor vendor, veçanërisht qytetarëve.

## REKOMANDIME

**Funksionalizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) kërkon ndërhyrje në disa aspekte:**

- **Infrastruktura e brendshme rregullatore:** KVSP-ja ka vlerë dhe mirëfunksionon kur veprimtaria e saj rregullohet përmes dokumenteve të brendshme, si rregullorja tip ose e standardizuar për organizimin dhe funksionimin e KVSP, e cila mund të përshtatet nga çdo bashki sipas kontekstit të saj lokal. Rregullorja shoqërohet me formate standarde dhe orientuese për mënyrën e funksionimit, përcakton rolet dhe përgjegjësitë e çdo anëtari të KVSP-së, protokollet dhe procedurat standarde të veprimit, instrumentat për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave si dhe rregullat e qarta për etikën dhe ruajtjen e konfidencialitetit si dhe komunikimin ndërinstitucional.
- **Hartimi i një metodologjie të unifikuar** e cila përfshin hapat metodik për funksionimin e KVSP-së. Ky instrument do përfshijë identifikimin dhe vlerësimin risqeve të sigurisë në nivel vendor. Instrumenti aprovohet nga një autoritet publik që ka në kompetencë fushveprimtarinë e KVSP. Metodologjia do të mund të zbatohet nga çdo bashki me qëllim zhvillimin e një plani shumaktorial për menaxhimin e risqeve të sigurisë publike në nivel vendor.
- **Ofrimi i trajnimeve** për anëtarët e KVSP-ve për vlerësimin e risqeve të sigurisë publike, planifikimin dhe ndjekjen e kërcënimeve të sigurisë në përgjigjeve të dinamikave dhe zhvillimeve në komunitetet vendore. Këshilli Bashkiak dhe administrata vendore duhet të rrisin kapacitetet e tyre teknike profesionale për të dhënë kontribut real e profesional në funksionimin e KVSP-së.
- **Rritja e kapaciteteve infrastrukturore, njerëzore dhe mbështetje financiare** për operacionalizimin e KVSP-së
- **Ndërgjegjësimi dhe informimi institucional** i të gjithë aktorëve dhe komuniteteve për rolin e institucioneve anëtare në KVSP në nivel vendor.

- **Koordinimi dhe bashkëpunimi i KVSP-ve me strukturat dhe mekanizmat e tjerë** në nivel vendor në trajtimin e problematikave të komunitetit. Mbledhja sistematike dhe e harmonizuar e të dhënave mbi çështjet e sigurisë, trajtimin e rasteve apo koordinimi ndërinstytucional me mekanizmat e tjerë vendor duhet të realizohet përmes një koordinimi më pro-aktiv dhe një praktikë të standartizuar.
- **Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese vendore/kombëtare** për përfshirjen e qytetarëve në mënyrë proaktive në konsultimin publik të hartës së rreziqeve ndaj sigurisë publike, në përputhje me veçoritë/dinamikat dhe njohjen e problematikave që shqetësojnë komunitetet vendore. Fushatat e advokimit dhe ndërgjegjësimit me mesazhe të orientuara drejt komuniteteve vendore në tërësi, të rinjve në shkolla të mesme dhe universiteteve si dhe grupeve vulnerabël mund të kontribuojnë në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve mbi këto fenomene.

## SHTOJCA

**Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR)** është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. MKR është një ekip ndërdisiplinor i profesionistëve të komunitetit të cilët kanë përgjegjësi institucionale për t'iu përgjigjur dhe adresuar nevojat e ndryshme të të mbijetuarve të dhunës në familje duke ndjekur një qasje *me në qendër viktimat*.

MKR përbëhet nga:

- a) Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- b) Ekipet teknike ndërdisiplinore;
- c) Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Komitetet drejtuese kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe në përbërje kanë:

- a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë;
- b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor;
- c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit;
- ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore;
- d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik;
- dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale, pranë bashkisë;
- e) Përfaqësuesin e zyrës së përmbarimit;
- ë) Përfaqësuesin e prefekturës;
- f) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit;
- g) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje;
- gj) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë;
- h) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- i) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

**Ekipi Teknik Ndërdisiplinor (ETN)** anëtarët e të cilit emërohen nga Komiteti Drejtues dhe janë përfaqësues teknikë të institucioneve anëtare të Komitetit Drejtues si dhe ofrojnë shërbime dhe mbështetje për të mbijetuarat e dhunës në familje në përputhje me mandatin e tyre përkatës. ETN është përgjegjës për:

- a) ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimave, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshtatshme;
- b) koordinimin dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve;
- c) menaxhimin e rasteve;
- ç) përcjelljen e të dhënave për rastet konkrete tek drejtuesit të ekipit teknik ndërdisiplinor;

d) monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

**Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN)** ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet ad-hoc, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.



Institute  
for Democracy  
and Mediation

---

